



Zyra për Bashkëpunim Ndërkombëtar e Universitetit "Kadri Zeka" në Gjilan, University

shpall këtë:

Planifikimi data:	20.12.2021
Numri:	0513194

Thirrje për aplikime për shkëmbim të stafit në Universitetin "Celal Bayar" Manisa, Turqi

Universiteti "Kadri Zeka" është pjesë e projektit KA107 ICM, Erasmus +, në partneritet me Universitetin e Manisas në Turqi.

Numri i Projektit Erasmus + KA107 (ICM) 2019-1-TR01-KA107-073710

Programi Erasmus + KA107 ose Shkëmbimi afatshkurtër i stafit (ICM) është një program i mobilitetit plotësisht i financuar që mundëson shkëmbimin e studentëve, stafit mësimdhënës dhe jo-mësimdhënës midis Universitetit Manisa Celal Bayar, Manisa, Turqi dhe Universitetit "Kadri Zeka" në Gjilan.

ICM Erasmus + mundëson shkëmbimin e stafit nga Universiteti "Kadri Zeka" - Gjilan për studim dhe trajnim / veprimtari nga të gjitha njësitë akademike dhe administrative të UKZ-së.

Kohëzgjatja e bursave:

- Staf akademik (në kohëzgjatje 5 ditë, + 2 ditë vajtje, ardhje)

Të gjitha shpenzimet janë të mbuluar nga projekti:

Shpenzimet e qëndrimit dhe 275 për udhëtim sipas Distance Calculator të Erasmus +

(http://ec.europa.eu/programmes/erasmus-plus/tools/distance_en.htm).

Granti i udhëtimit do të paguhet para lëvizjes.

Shënim:

- 1) Të gjithë pjesëmarrësit duhet t'i përmbahen kufizimeve të alokuara buxhetore pasi që nuk ka fonde shtesë.
- 2) Buxheti i udhëtimit llogaritet sipas llogaritësit të udhëtimit dhe edhe nëse tarifa e biletës tejkalon shumën e mbështetjes së udhëtimit, nuk mund të jepen fonde shtesë për pjesëmarrësit.

APLIKIMI dhe PËRZGJEDHJA

Kriteret për aplikim për stafin janë:
Të jeni mësimdhënës/punëtor i rregullt në UKZ

Dokumentet e nevojshme për aplikim:

- CV
- Lista e publikimeve për stafin akademik (në gjuhën angleze)
- Kopja e Pasaportës
- Certifikata e gjuhës angleze (Niveli minimal i gjuhës angleze B2)
- Letër mbështetëse nga stafi akademik i Universitetit të Manisas (i/e cila pajtohet për të bashkëpunuar gjatë qëndrimit tuaj një javor në Manisa)
- Kontrata e punës me UKZ

Përzgjedhja bëhet:

Në bazë të fushës së përafërt të ligjërimit me fushat e ofruara nga universiteti prites 50%
Gjuhë e huaj: 50%

PROCEDURA E APLIKIMIT

1. Aplikimet duhet të dorëzohen në Zyrën për Bashkëpunim Ndërkombëtar (kopje fizike) ose përmes emailit internatioanlooffice@uni-gjilan.net, datave 17 Dhjetor 2021 dhe 24 Dhjetor 2021. Aplikimet e vonuara nuk do të pranohen.
2. Të gjithë aplikantët duhet të jenë në gjendje të sigurojnë dëshminë/ certifikatën e gjuhës angleze, niveli C1
3. Formulari i aplikimit duhet të shtypet, të nënshkruhet dhe t'i dorëzohet me dokumente të tjera të kërkuara (<https://drive.google.com/drive/u/1/folders/1AEnbi4qKpfim0bjRp198ldhtKjjRm8yV>)
4. Rezultatet e aplikimit do të shpallen në www.uni-gjilan.net

Për cdo informatë shtesë, kontaktoni zyrën për bashkëpunim ndërkombëtar në UKZ.

Me respekt,



Prof. Assoc. Dr. Dukagjin Leka
Prorektor për Bashkëpunim Ndërkombëtar